



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

# **“KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM PËR NAFTË, GAZ DHE UJË”**

**X-II-20**

**Niveli i dytë në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit II të KEK<sup>2</sup>**

Tiranë, 2020

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë			Kodi X-II-20
	Kohëzgjatja	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, niveli II-të i KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë, në nivelin ndihmës, për t’u punësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Shpimit të puseve dhe në shërbimet e ofruara nga këto fusha, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, të nivelit II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si ndihmës në sipërmarrje të ndryshme të kërkimeve, shpimeve dhe shfrytëzimeve të vendburimeve të naftës e gazit, të shpimeve për kërkim zbulimin e mineraleve të dobishme, të shpimeve për kërkimin dhe shfrytëzimin e ujërave nëntokësore, të shpimeve për studime gjeologo-inxhinierike, të shpimeve për qëllime injektimi dhe për qëllime të tjera speciale etj..</p> <p>Gjithashtu individit ka mundësi të punojë si ndihmës në shfrytëzimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit, në sektorët e grumbullimit dhe transportit të naftës dhe gazit, në mjedisin e dekantimit të naftës dhe gazit, si edhe uzinat e përpunimit të naftës.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, të kualifikimit profesional (njëvjeçar), në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtejshëm ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturën Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	X-II-16			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI

### Të përgjithshme

- Të përshkruajë dokumentacionin teknik të profesionit të rilevuesit, sondistit, përgjegjësit të kyçit, pontistit (punëtorit të manovrave) si dhe operatorit të prodhimit dhe në veçanti të projekteve për shpimin e puseve dhe të nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Të përshkruajë vizatimet teknike dhe skemat teknologjike të proceseve të ndryshme profesionale si; prerje gjeologjike, harta strukturale, konstruksion pusi shpimi dhe konstruksion pusi shfrytëzimi;
- Të klasifikojë materialet dhe lëndët e para që përdoren në proceset e shpimit, nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit dhe operacioneve që lidhen me to;
- Të përshkruajë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të materialeve dhe të lëndëve të para që përdoren në teknologjinë e shpimit dhe shfrytëzimit të naftës dhe gazit;
- Të përshkruajë veçoritë e punës në proceset e shpimit, shfrytëzimit naftës, gazit dhe ujit, si dhe operacioneve që lidhen me to;
- Të përshkruajë parime të përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në industrinë e naftës (gjeologji, punimet e shpimit dhe të shfrytëzimit në veçanti);
- Të përshkruajë objektin e punës dhe veçoritë e proceseve të punës së gjeologut, shpuesit, kryesondatorit, sondistit, pompistit, pontistit, shllamistit, motoristit, prodhuesit, etj.;
- Të listojë mjetet, pajisjet dhe veglat e punës që përdoren në shpim, kërkim apo shfrytëzim të naftës, gazit dhe ujit;
- Të përshkruajë karakteristikat e pajisjeve që përdoren në shfrytëzimin e naftës dhe gazit si; pompat e thellësisë, purtekat, vulfet (lëkundësit), filtrat , pakerat etj.;
- Të përshkruajë objektin e punës dhe veçoritë e proceseve të punës së: kërkimit, të montimit, çmontimit dhe transportit të sondave, të gjeologut të kërkimit, sondistit , të remontit nëntokësor të puseve të shfrytëzimit, etj.;
- Të listojë llojet e instrumenteve matës sipas përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë parimin e punës së instrumenteve matës që përdoren në proceset e shpimit, nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit dhe operacioneve që lidhen me to;

### Organizimi i punës

- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale;
- Të tregojë rëndësinë e kontrollit vizual të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së bazën materiale, veglave dhe pajisjeve sipas procesit të punës;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e sigurimit të zonës duke vendosur shenjat/tabelat

paralajmëruese;

- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit të punës në vazhdimësi me kolegë, teknikë dhe inxhinierë;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit;
- Të tregojë rëndësinë e dokumentimit të punës së kryer dhe raportimit në kohë;
- Të përshkruajë rëndësinë e pastrimit dhe sistemit të vendit të punës;

## **Shpim**

- Të listojë llojet e puseve të shpimit (kërkimi, vlerësimi, konturimi, shfrytëzimi, puse të cekët, të thellë dhe shumë të thellë, puse me inklinim (shtrembërim) të përcaktuar, puse për qëllime të veçantë, etj.);
- Të shpjegojë veçoritë e puseve të shpimi sipas llojeve të tyre;
- Të klasifikojë sondat e shpimit të puseve;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse të një sonde shpimi dhe mënyrën e funksionimit të pajisjeve përbërëse të saj;
- Të përshkruajë proceset e punës të shpimit të një pusi, të përgatitjes së rrugës dhe sheshit të shpimit;
- Të përshkruajë procesin e montimit dhe kolaudimit i sondës, kontrolli i këndit të shpimit në përputhje me projektin;
- Të përshkruajë përgatitja e bazës materialo-teknike të nevojshme për fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e pusit deri në projekt;
- Të përshkruajë procedurën për montimin dhe çmontimin e sondës së shpimit;
- Të përshkruajë përdorimin e makinerive në procesin e shpimit;
- Të përshkruajë metodat e shpimit me rotor dhe me motor ballor ( hidroturbinë dhe elektroturbinë);
- Të përshkruajë procedurën e realizimit të montimit dhe çmontimit të pjesëve përbërëse të kolonave të shpimit;
- Të përshkruajë funksionet e kolonës së shpimit;
- Të tregojë përbërjen e një kolone shpimi duke filluar nga dalta e deri tek tubo drejtuese (astakuadra);
- Të shpjegojë rëndësinë dhënies së peshës aksiale mbi dalte
- Të shpjegojë rëndësinë e shtimit apo pakësimit të tubove rëndues, sipas e peshës së kërkuar aksiale mbi daltë;
- Të përshkruajë veprimet gjatë operacioneve të shpimit, manovrave lart e poshtë, manovrave të shkurtra dhe uljeve të pajisjeve të tjera në pus;
- Të përshkruajë instrumentet shkëmb-shkatërrues (daltat dhe koronat), tipet dhe llojet e tyre,;
- Të përshkruajë funksionimin dhe përdorimet e daltave me elementë të lëvizshëm dhe të palëvizshëm, karotiere dhe dopjo karotjere (për marrje kampioni), të shkallëzuara;
- Të përshkruajë funksionimin, ndërtimin dhe përdorimin e daltave hidromonitor;

- Të përshkruajë mënyrat e zgjedhjes së daltave të shpimit, tipet e daltave dhe veçoritë e secilit tip, klasifikimi i daltave sipas kodit IADC;
- Të përshkruajë procedurat e fillimit të procesit të shpimit me një dalje të re;
- Të përshkruajë konstruksionin e pusit;
- Të përshkruajë procesin e tubimit të një pusi;
- Të listojë pajisjet që përdoren në procesin e tubimit;
- Të përshkruajë skemat e pajisjes së fundit të kolonave të rrethimit, (pastat e lyerjes së filetove dhe shtrëngimin e tyre gjatë uljes së kolonave të rrethimit në pus);
- Të listojë llojet e çimentimit të puseve të ndryshëm;
- Të përshkruajë procesin e çimentimit, mjetet, pajisjet që nevojiten për kryerjen e çimentimit;
- Të përshkruajë shtrembërimin natyror të puseve;
- Të shpjegojë qëllimin e shpimit të puseve të orientuar;
- Të përshkruajë rëndësinë e matjeve e të shtrembërimit dhe orientimit të pusit;
- Të shpjegojë qëllimin e përdorimit dhe funksionet e lëngut larës në pus;
- Të shpjegojë sistemin e qarkullimit të lëngut larës në pus;
- Të listojë llojet e lëngjeve larës për shpimin e puseve;
- Të listojë parametrat e lëngut larës;
- Të përshkruajë transportin e shllamit nga balli i pusit në sipërfaqe gjatë shpimit, nga lëngu larës;
- Të tregojë skemat e pastrim-degazifikimit të lëngjeve larëse, mënyrat e mirëmbajtjes dhe të funksionimit të tyre;
- Të përshkruajë rëndimin e lëngjeve larës;
- Të listojë ndërlikimet që ndodhin gjatë shpimit të puseve;
- Të tregojë dukurinë e humbjeve të lëngut larës në pus;
- Të përshkruajë masat parandaluese dhe ato mënjauese të humbjeve të lëngut larës;
- Të përshkruajë shenjat e ardhjeve të fluideve nga shtresa në pus si pararendëse të rrezikut të fontanimit të pusit;
- Të tregojë pajisjet hermetizuese (preventorëve) të grykës së pusit dhe linjat e shkarkimit e të nënshtrimit të ardhjeve;
- Të listojë llojet e avarive (në kolonën e shpimit, kolonën e rrethimit, daltat etj.),
- Të listojë metodat dhe mjetet e eliminimit të avarive ;
- Të përshkruajë mënyrat e vënies në shfrytëzim të puseve të naftës dhe gazit,;
- Të përshkruajë procedurat për vënien e pusit në konservim;
- Të përshkruajë operacionin e likuidimit të pusit;

### **Shfrytëzim i naftës dhe gazi**

- Të përshkruajë qëllimin e shfrytëzimit të naftës dhe gazit;
- Të përshkruajë gjendjen fizike të naftës dhe gazit në kushtet e shtresës në trungun e pusit dhe në

sipërfaqe;

- Të përshkruajë depresionin e shfrytëzimit;
- Të përshkruajë regjimin natyror të ujërave elastikë;
- Të përshkruajë regjimin e gazit të tretur, kur vepron dhe cili është mekanizmi;
- Të përshkruajë regjimin e përpunimit të shtresave të naftës e të gazit;
- Të përshkruajë ndotjen e shtresës prodhimtare, ndikimet negative të ndotjes së shtresës, pasojat që sjell dhe si mund të zvogëlohen kjo ndotje;
- Të përshkruajë përvetësimin e pusit, qëllimi dhe mënyrat e realizimit të tij;
- Të klasifikojë metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës dhe gazit;
- Të përshkruajë pajisjet mbi dhe nëntokësore të puseve që shfrytëzohen me fontanim natyror;
- Të përshkruajë rolin e duzave në shfrytëzimin me fontanë;
- Të përshkruajë ndërprerjen e fontanimit natyror dhe kalimin në forma të tjera të shfrytëzimit;
- Të përshkruajë shfrytëzimin e puseve me mjetet të mekanizuara;
- Të përshkruajë metodat e shfrytëzimit që përdoren për nxjerrjen e naftës dhe gazit nga shtresa në sipërfaqe;
- Të përshkruajë aparaturat e matjes së parametrave fiziko-kimikë të naftës dhe gazit;
- Të përshkruajë pajisjet e kokës së kolonës dhe atë të grykës së pusit në rastet kur shfrytëzimi bëhet me vet-ardhje (fontanë), me ajër dhe gazngritës, pompë me piston, pompë me burmë, pompë me ezhektor ;
- Të përshkruajë mënyrat dhe radhën e veprimeve për vënien e një pusi nafte në shfrytëzim;;
- Të përshkruajë shkaqet që detyrojnë remontin nëntokësor të një pusi nafte dhe një pusi gazi;
- Të përshkruajë përbërjen e kolonës së shfrytëzimit të një pusi nafte apo gazi;
- Të përshkruajë përbërjen e kolonës së tubove pompë-kompresor në rastet kur pusi shfrytëzon naftë apo shfrytëzon gaz;
- Të përshkruajë tipet e pompave të thellësisë dhe veçoritë konstruktive, fushën e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë radhën e punës që duhet të ndjekë, në rastin kur në një pus nafte apo gazi, do ulen apo do ngrihen tubot pompë-kompresor;
- Të listojë mjetet e punës që nevojiten gjatë kryerjes së procesit të uljes dhe ngritjes së kolonës së tubove pompë-kompresor në një pus që shfrytëzon naftë dhe/ose gaz;
- Të përshkruajë pajisjet e kolonës së tubove pompë-kompresor të një pusi që shfrytëzon naftë dhe/ose gazi;
- Të listojë përbërësit më të rrezikshëm të naftës dhe gazit për jetën e punonjësve dhe për pajisjet mbi dhe nëntokësore dhe masat për parandalimin dhe mënjanimin e rreziqeve që sjellin ata;
- Të përshkruajë metodat e komunikimit të shtresës me kolonën e shfrytëzimit mbasi ulet dhe çimentohet kjo e fundit, para se pusi të vihet në shfrytëzim;
- Të përshkruajë metodat e përforcimit dhe pajisjes me filtra të pjesës së kolonës së shfrytëzimit përballë shtresës prodhimtare;

- Të listojë pajisjet mbi dhe nëntokësore të shfrytëzimit me pompë thellësie me purteka;
- Të përshkruajë rolin e kondrapeshës tek lëkundësi, gjatë ngritjes së lëkundësit dhe uljes së tij;
- Të përshkruajë pompat me burmë pa fund, kur përdoren, llojet dhe konstruksioni i tyre dhe fushat e përdorimit;
- Të përshkruajë përvetësimin e shtresës prodhimtare;
- Të përshkruajë klasifikimin e metodave të shfrytëzimit të puseve të naftës;
- Të përshkruajë pajisjet mbi dhe nëntokësore të puseve që shfrytëzohen me fontanim natyror;
- Të përshkruajë mënyrën e kryerjes së llogaritjeve të thjeshta që lidhen me projektin e shfrytëzimit të një vendburimi nafte dhe gazi;
- Të përshkruajë rëndësinë e remontit gjatë shfrytëzimit të puseve;
- Të listojë proceset e punës që lidhen me remontin kapital të sistemit të shfrytëzimit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e fotografimit të avarive me anën e uljes së stampave;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes dhe ruajtjes së të dhëna të sakta gjatë uljes së purtekave në pus;
- Të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes së pajisjeve të punës;

#### **Trajtimi dhe dekantimi i naftës bruto**

- Të përshkruajë mënyrën e shkarkimit të H<sub>2</sub>O nga depot;
- Të përshkruajë mënyrën dhe mjetet e kontrollit të parametrave në furrën e ngrohjes së naftës bruto;
- Të përshkruajë rëndësinë e analizës së % së elementëve të huaj në depon e naftës;
- Të tregojë mënyrën e mirëmbajtjes së depove të naftës;
- Të tregojë mënyrën e marrjes së kampionit të naftës nga ventilat për në laborator;
- Të shpjegojë rëndësinë e monitorimit të parametrave të pompës shtytëse në rast bllokimi;
- Të listojë disa procese të veçanta të operacioneve të trajtimit të naftës e gazit;

#### **Gjeologji**

- Të shpjegojë objektin e studimit të gjeologjisë dhe veçoritë e metodave të studimit që përdoren në gjeologjinë e kërkimit të naftës dhe gazit (si ato rilevuese, të gjeofizikës fushore: sizmike, gravimetrike, elektrometrike etj);
- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës të gjeologjisë së kërkimit ;
- Të përshkruajë elementët strukturalë të kurtheve ku grumbullohen hidrokarburet;
- Të përshkruajë ç'është nafta dhe gazi, si formohet ai dhe cilat janë format e ndodhjes së tyre në natyrë;
- Të përshkruajë si është përbërja fiziko-kimike e naftës dhe gazit dhe e nënprodhimeve të tyre;
- Të klasifikojë naftën dhe gazet sipas përbërjes kimike të tyre dhe të listojë përfaqësuesit kryesorë të çdo klase;
- Të përshkruajë ç'është shkëmbi, si formohet dhe vetitë kryesorë të tij;
- Të përshkruajë ndarjen e shkëmbinjve në bazë të kushteve të formimit dhe dallimet nga njëri-

tjetri;

- Të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme (format e shtrirjes, struktura, tekstura, ndashmëria) të shkëmbinjve magmatikë, sedimentarë e metamorfikë, si dhe karakteristikat dalluese nga njëri-tjetri;
- Të përshkruajë në përgjithësi rolin dhe rëndësinë e hartografimit gjeologjik dhe të listojë metodat e ndërtimit të hartave gjeologjike ;
- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së provave dhe kampioneve gjatë punimeve fushore të kërkimit;
- Të përshkruajë dokumentimin e shfaqjeve gjeologjike gjatë punimeve të rilevimit ;
- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së kampioneve, ruajtjes dhe etiketimit të tyre, vlerat e çdo kampioni të marrë për studime komplekse të stratigrafisë, mineralogjisë, të fizikës dhe mekanikës së shkëmbit, të gjeokimisë etj.;
- Të përshkruajë metodat dhe mënyrat e hartografimit gjeologjik;
- Të përshkruajë një hartë gjeologjike, hidro-gjeologjike, tektonike, gjeo-morfologjike, gjeo-mjedisore dhe të rrezikut gjeologjik;
- Të përshkruajë standardet dhe organizimin e punimeve për kryerjen e hartografimeve gjeologjike shumë disipline në shkallë të ndryshme;
- Të përshkruajë provat dhe kampionet si dhe të shpjegojë etiketimin, ambalazhimin dhe dorëzimin e tyre në laboratorët përkatës;
- Të përshkruajë fazat dhe strukturën e përpilimit të raporteve gjeologjike.

### **Teknika e sigurimit**

- Të listojë rreziqet që paraqiten gjatë punës në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë (gjeologji, punimet e shpimit dhe të shfrytëzimit në veçanti );
- Të përshkruajë mënyrën e parandalimit dhe mënjanimit të rreziqeve që paraqiten gjatë punës në industrinë e naftës ;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë sipas proceseve të punës
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë;
- Të shpjegojë rëndësinë e rehabilitimit të mjedisit mbas përfundimit të punimeve;
- Të përshkruajë masat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së ambientit gjatë kryerjes së proceseve të remontit nëntokësor dhe kohës së shfrytëzimit të një pusi nafte dhe/ose gazi;
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në punimet e kërkimit, shpimit dhe ato të shfrytëzimit :
- Të përshkruajë parimet e klasifikimit të aksidenteve të ndodhura dhe regjistrimin e tyre në ditarin e sigurisë në punë dhe të shëndetit
- Të listojë rreziqet që vijnë nga prania e gazeve helmuese në kantieret e shfrytëzimit të naftës



dhe gazit, në raste të manifestimeve apo edhe në rastet e fontanave të hapura;

- Të përshkruajë burimet e aksidenteve gjatë kryerjes së proceseve të manovrave në shpimin e puseve dhe në shfrytëzimin e naftës dhe gazit ;
- Të përshkruajë rreziqet nga pajisjet elektrike në kushte punë normale dhe në ditë me shira dhe lagështi;
- Të përshkruajë dëmtimet e shëndetit nga zhurmat që krijohen gjatë punës së sondave, traktorëve, vinçave, motosaldimi, etj., masat mbrojtëse dhe pajisjet personale, si dhe dëmtimet e shëndetit nga kushtet e vështira atmosferike në periudhat e ftohta dhe me reshje dëbore;
- Të listojë mjetet mbrojtëse individuale gjatë kryerjes së punimeve kërkuese në terren, në procesin teknologjik të shpimit, në punimet e remontit nëntokësor të puseve të shfrytëzimit të naftës dhe gazit, si dhe njohuritë për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentimi;
- Të përshkruajë burimet e aksidenteve nga makineritë e ndryshme që funksionojnë në sondën e shpimit, në traktorët dhe sondat e remontit nëntokësor të puseve të shfrytëzimit, etj.;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, si dhe rolin e ndriçimit dhe krijimin e kushteve të sigurta në punë;
- Të përshkruajë përdorimet e mjeteve të mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, përdorimit të metodave të dyta;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Individi duhet të jetë i aftë:

### **Të përgjithëshme**

- Të organizojë vendin e punës sipas proceseve të punës;
- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës sipas operacioneve përkatëse;
- Të kryejë kontrollin pamor të vazhdueshëm të veglave që përdor;
- Të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e punës sipas operacioneve përkatëse;
- Të menaxhojë probleme të thjeshta që lidhen me ruajtjen e mjedisit;
- Të respektojë standardet dhe etikën e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;

### **Organizimi i punës**

- Të përdorë pajisjet mbrojtëse personale gjatë proceseve të ndryshme të punës;
- Të kryejë kontroll vizual të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përzgjedhë bazën materiale, veglave dhe pajisjeve sipas procesit të punës sipas

udhëzimeve;

- Të kryejë sigurimin e zonës duke vendosur shenjat/tabelat paralajmëruese;
- Të koordinojë punën në vazhdimësi me kolegë, teknikë dhe inxhinierë;
- Të zbatojë format dhe mënyrat e duhura të raportimit;
- Të dokumentojë punën e kryer dhe të raportojë në kohë;
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;

### **Shpim**

- Të përdorë veglat e punës si elevatore, kunja, kyçet universalë, kyçet me moment shtrëngimi, kyçet me zinxhirë (katen), pallakinat, ngritësit etj.;
- Të përdorë agregatët kryesore të sondës së shpimit;
- Të përdorë pajisjet hermetizuese të grykës së pusit;
- Të përdorë pajisjet e përpunimit kimik të lëngut larës;
- Të demonstrojë vënien në punë të pompave të lëngut larës;
- Të demonstrojë mbërthimin dhe zbërthimin e kompletit karotier për sigurimin e karotës;
- Të demonstrojë etiketimin, ambalazhimin dhe sistemimin e kampioneve të marrë nga pusi gjatë procesit të shpimit, sipas metodikave dhe instruksioneve të miratuara;
- Të zbatojë servisën javor të pajisjeve të sondës;
- Të përdorë dhe të përshtasë për përdorim optimal pajisjet e pastrimit të shllamit si sitat dridhëse, hidrociklonet, rërëndarësit, llumëndarësit, kanalet, vaskat, etj.;
- Të demonstrojë operacionet e ulje-ngritjes së instrumentit të shpimit;
- Të demonstrojë shtimin e tubove rëndues dhe të centratorëve, për realizimin e peshës mbi dalte (ose te kolones) dhe mbajtjen e këndit të shpimit / qoftë dhe atë të orientuar në kabinetet e praktikave profesionale;
- Të përdorë mjetet për marrjen e këndit të orientuar (vendosja e pajisjeve përkatëse në fundin e pusit);
- Të demonstrojë përdorimin e kyçeve dhe litarëve për zbërthimin, mbërthimin dhe shtrëngimin e tubave të shpimit;
- Të përdorë ganxhat dhe litarët në urën (pontin) e manovrës për mbështetjen e tubave të shpimit gjatë manovrave të ulje-ngritjes së instrumentit të shpimit;
- Të zbatojë procedurat e marrjes së kampioneve të lëngut larës dhe të shllamit për analiza laboratorike;
- Të rendisë në urën e sondës, tubat e kolonës së rrethimit sipas radhës së uljes së tyre në pus;
- Të demonstrojë procedurën e shabllonimit të kolonës së rrethimit;
- Të kryejë mbërthimin e tubave të kolonës së rrethimit;
- Të kryejë punime të thjeshta me vegla dhe agregate të thjeshta;
- Të vlerësojë qarkullimin e lëngjeve larës dhe të raportojë për problemet që dalin;
- Të kryejë veprime praktike për ngritjen e kolonave të shpimit;
- Të vendosë daltat për shpimin e shkëmbinjve të caktuar në pajisjet përkatëse;

- Të kryejë veprime të thjeshta praktike gjatë shpimit të puseve;

### **Shfrytëzim nafte dhe gazi**

- Të përgatisë skica dhe vizatime teknike të thjeshta të konstruksionit të pusit si dhe të kompletimit të tubingut për një teknologji të veçantë shfrytëzimi ;
- Të kryejë matje dhe kontrolle me instrumentet përkatës në çdo pus shfrytëzimi si me ehollot (viskozimeter), manometra, termometra, densimetra, të masë nivelet e vaskave në një grup grumbullimi nafte dhe ti dokumentojë ato, etj.;
- Të përgatisë pusin për uljen e pompës së thellësisë në kabinet;
- Të llogarisë volumin e prodhimit ditor të një pusi apo të një grup pusesh;
- Të llogarisë faktorin ujë/naftë të një pusi konkret shfrytëzimi nafte dhe ta dokumentojë atë;
- Të demonstrojë vënien e puseve në punë në faza të ndryshme të shfrytëzimit të vendburimit;
- Të asistojë në përgatitjen e pajisjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore për kryerjen e metodave të veprimit në shtresë në kabinet;
- Të asistojë kompletimin e lëkundësit me nyjet kryesore, si kulla, reduktori, trari, koka e lëkundësit (trarit), elektromotori dhe pjesët ndihmëse e mbrojtëse;
- Të asistojë në përgatitjen dhe të vënien në punë lëkundësin për nxjerrjen e naftës me pompë thellësie;
- Të demonstrojë lidhjen pajisjeve sipërfaqësore (grykës së pusit) dhe nëntokësore për shfrytëzimin me erupsion natyror (vetë ardhje);
- Të demonstrojë montimin aparatet për matjen e debitit të fluideve në pus ose në depon e grumbullimit.
- Të monitorojë aparatet për kontrollin e punës së pusit;
- Të asistojë në uljen e pompës me burmë - pafund deri në thellësinë e kërkuar;
- Të asistojë në montimin e stabilizimit të lëkundësit duke ndërhyrë me kondrapeshat;
- Të asistojë në përgatitjen e pajisjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore për kryerjen e proceseve të stimulimit të puseve;
- Të kryejë llogaritjeve të thjeshta që lidhen me projektin e shfrytëzimit të një vendburimi nafte dhe gazi;
- Të kryejë punime ndihmëse gjatë remontit të puseve;
- Të monitorojë dhe ruajë të dhëna të sakta gjatë uljes së purtekave në pus;
- Të kryejë mirëmbajtje të thjeshta të pajisjeve të punës;

### **Trajtimit dhe dekantimit të naftës bruto**

- Të kryejë shkarkimit të H<sub>2</sub>O nga depot sipas udhëzimeve;
- Të monitorojë parametrat në furrën e ngrohjes së naftës bruto;
- Të dallojë elementë të huaj në depon e naftës;
- Të kryejë mirëmbajtjes të thjeshta të depove të naftës;

## **Gjeologji**

- Të kryejë hartografime të thjeshta të terrenit ku do të bëhen punime gjeologo-kërkuese;
- Të kryejë veprime praktike në hapjen e punimeve gjeologjike sipërfaqore si kanale, gropa duke dalluar elementët gjeologjikë që ekspozohen në to;
- Të përgatisë materialet e nevojshme për dokumentimin gjeologjik;
- Të përdorë busullën gjeologjike dhe busullën e varur;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të punimeve të shpimit për kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin e vendburimeve të naftës dhe gazit;
- Të kryejë marrjen e shllamit për analiza;
- Të dallojë format e thjeshta kryesore të kristaleve.
- Të përgatisë materialet e nevojshme për të kryer dokumentimin gjeologjik;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të kampioneve të mineraleve e të shkëmbinjve, si dhe të shllameve, gjatë procesit të shpimit të puseve;
- Të kryejë matje e shtresave gjeologjike me instrumentet përkatëse
- Të dallojë me sy veçoritë e përgjithshme të proceseve gjeologjike të jashtme (ekzogjene) e të brendshme (endogjene), bashkëveprimin midis tyre dhe si ndahen ato.
- Të dallojë vetitë fizike të mineraleve me sy, si dhe duke përdorur mjete të thjeshta.
- Të dallojë shenjat me interes gjeologjik që paraqet lëngu larës gjatë shpimit të pusit.
- Të dallojë me sy veprimtarinë gjeologjike të shkaktuar nga faktorë të brendshëm (lëvizjet malformuese, lëvizjet luhatëse, tërmetet, magmatizmi, metamorfizmi).
- Të dallojë veprimtarinë gjeologjike shkatërruese, transportuese dhe akumuluese të shkaktuar nga faktorët e jashtëm (tjetërsimi, veprimtaria e erës, e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore, e lumenjve, e ujërave nëntokësore, e liqeneve dhe deteve).

## **Teknika e sigurimit**

- Të zbatojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në shpimin e puseve për naftë, për gaz dhe ujë, nxjerrjen e naftës dhe gazit dhe gjeologji;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe masat mbrojtëse naftës dhe gazit, në simulimet nga prania e gazeve shoqërues të naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet e aksidenteve në bazën e sondës, tek motorët, pompat, sistemi i qarkullimit të lëngut larës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet e fontanave të hapura të naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë manovrave për uljen dhe ngritjen e instrumentit të shpimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë ndërlikimeve dhe avarive të ndryshme gjatë shpimit të pusit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet kur ka prezencë të gazit sulfidrik (H<sub>2</sub>S);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë uljes së kollonave të rrethimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë çimentimit të pusit;

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet për rënie zjarri në sondë;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë shfrytëzimit me fontanim të puseve të naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë shfrytëzimit të puseve me pompë thellësie;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë remontit nëntokësor të puseve të naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet në stacionet e dekantimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në simulimet gjatë grumbullimit dhe transportit të naftës dhe gazit;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse ndaj gazrave helmues, zhurmave dhe pluhurave;
- Të demonstrojë përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe dhënien e ndihmës së parë;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike;
- Të respektojë standardet e ndriçimit për krijimin e kushteve të sigurta në punë;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje-ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, shfrytëzimit të puseve, përdorimit të metodave të dyta etj.;
- Të zbatojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në kërkim, në procesin e transportit, montimit dhe çmontimit të sondave;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe masat mbrojtëse në simulimet nga prania e gazeve helmues gjatë kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit ;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të materialeve që përdoren në shpimin dhe shfrytëzimin e puseve të naftës dhe gazit ;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse nga rënia në tension elektrik, mbrojtjes nga zjarri, dhe ruajtjes së pastërtisë dhe higjienës së ambientit ku punohet;
- Të demonstrojë përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe dhënien e ndihmës së parë;
- Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, në kushte punë normale dhe në ditë me shira dhe lagështi;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje-ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, përdorimit të metodave intesifikuse dhe të dyta etj. ;

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë arritjet e tij, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej.